



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:266781

Datë: 22.02.2022

Numri i dokumentit: 02739038

PKR.nr.190/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V.H, nga fsh.B K I, për shkak të veprës penale, “përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe për shkak të veprës penale “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, PP/I.nr.246/21 të datës 25.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Agron Galani, të akuzuarit V.H, me datë 09.02.2022 merr dhe me dt.22.02.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari V.H, i lindur me datë në fshatin B K.I, me vendbanim në të njëjtin fshat , i biri i R nënës B , ka të kryer shkollën e mesme i, i pa punë, invalid i gjendjes dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit të lëshuar nga MPB Republika e Kosovës me numër personal....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

I

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Me datë 13.09.2021 në I në shtëpinë e tij e cila gjendet në Rrugën,,..... në B të I, përdor armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, dhe atë pistoletën e tij të markës G 9x19mm,modeli R.M, prodhim turk, me numër seriknë atë mënyrë që me rastin e një ahengu familjar i pandehuri shtien nga gëzimi, në oborrin e shtëpisë së tij, ka shtënë disa herë në ajër,

Me çka ka kryer vepër penale, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 4, 7,17,38,46,47,48,49,69 70, të KPRK-së, nenit 367 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPRK-së, të akuzuarit V.Hi shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit V.H, për veprë penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale.

Të akuzuarit i konfiskohet përhershëm arma markës G 9x19mm, modeli R.M, prodhim t., me numër serike të sekuestruara përkohësisht sipas vërtetimit nr. 2021-DF-448 datë 13.09.2021.

I akuzuari obligohet që gjykatës ti paguaj shumën prej 25€ (njëzet e pesë euro), në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

II

Sa i përket dispozitivit II të aktakuzës konform nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së ndaj të akuzuarit V.H

REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

Më parë e gjerë me datën 13.09.2021, në fshatin B K I, në mënyrë të pa autorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 lidhur me par.1.1.9 dhe nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll një pistoletë të markës G 9x19mm, modeli R.M, prodhim t., me numër serik ...,dhe një karikator (njëmbëdhjetë) gëzhoja, të cilat hetuesit e Stacionit Policor në i i kanë sekuestruar nga i pandehuri.

-Me çka kishte për të kryer veprë penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Për shkak të heqjes dorë të prokurorit të shtetit nga dispozitivi i dytë i aktakuzës nën PP/I.nr.246/21 të datës 25.11.2021 për të akuzuarin V.H në shqyrtim fillestarë, për veprë penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.246/21 të datës 25.11.2021 , ndaj të akuzuarit V.H , për shkak të veprës penale, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe për shkak të veprës penale “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 09.02.2022, Prokurori i Shtetit me rastin e leximit të aktakuzës PP/I.nr.246/2021, deklaroi se heqë dorë nga dispozitivi i dytë i aktakuzës ndaj të pandehurit V., për veprë penale “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, me arsyetimin se i njëjti është akuzuar se me datë 13.09.2021 në mënyrë të pa autorizuar ka mbajtur në pronësi një pistoletë të markës G

9x19mm, modeli R.M, prodhim turk, me numër serik T6368-20A00397, duke shtuar se pasi i pandehuri prezantoi lejen e armës është vërtetuar se ka qenë valide dhe vazhdon të jetë e afatshme dhe atë nga data nga data 07.05.2021 deri me datën 07.05.2016, ndërsa akuza pretendon se vepra është kryer me datë 13.09.2021, pra në kohën kur i pandehuri ka qenë i pajisur me leje valide. Seanca ka vazhduar në raport me dispozitivin e parë të aktakuzës, ku prokurori ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës sa i përket dispozitivit të parë të aktakuzës duke vazhduar leximin e të njëjtës.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari, ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimin të fajësisë dhe i njëjti deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale “përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Prokurori shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit meqenëse një pranim i tillë është i bazuar edhe në shkresat e lëndës ngase i njëjti këtë vepër penale e ka pranuar në të gjitha procedurat penale, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtën ta aprovoj.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për vepër penale si në dispozitivin e parë të aktakuzës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin duke pas parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti i oficerit me nr. të rastit ...-DF...dt.13.09.2021, deklarata e të pandehurit V.H e dhënë në polici me dt.13.09.2021,dhe në prokurori me dt.23.11.2021,raporti nga vendi i ngjarjes i dt.13.09.2021,vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt.13.09.2021, lista e dëshmive e dt.13.09.2021,raporti i shitjes së armëve, pjesëve të tyre dhe municionit i dt.28.04.2021,vërtetimi dëshmues për qitje provuese i dt.20.07.2020,pëlqimi për blerje të armës nga personi fizik i dt.19.11.2020,certifikata për shënjimin e armëve e dt.20.08.2020,raporti i shpejtë i dt.13.09.2021,fotodokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e i akuzuari ka pranuar fajësinë, pendimin e tij për veprën e kryer penale, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti më parë ka ra ndesh me ligjin, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Konform nenit 366 par.3 dhe 367 par.1 të KPRK-së konfiskohet përhershëm arma e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e të sekuestruara përkohësisht sipas vërtetimit nr. ...-DF-... datë 13.09.2021, pasi që i njëjti kishte keqpërdorur lejen përkatëse për mbajtjen e armës në fjalë ashtu që kishte përdorur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët(i njëjti kishte leje vetëm për shenjtori).

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Ndaj të akuzuarit V.H gjykata në kuptim të nenit 363 par. 1 të KPPK-së e refuzoi aktakuzën si në dispozitiv të dytë të këtij aktgjykimi, meqenëse prokurori i shtetit hoqi dorë nga pika e dytë e aktakuzës PP/I.nr.246/21 të datës 25.11.2021 dhe nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit V H për shkak të veprës penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2021:266781, 22.02.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.